

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sketching Pristina: Artistë nga Kosova, Franca dhe Spanja vizatojnë qytetin me mbështetjen e BE-së
ADRESA	https://indeksonline.net/sketching-pristina-artiste-nga-kosova-franca-dhe-spanja-vizatojne-qytetin-me-mbeshtetjen-e-be-se/
BURIMI	indeksonline.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 01:03:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	4 shtator 2026, 13:26:49 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2a6a4651f96585e166c57c9639321b7aace23e9c6ffbfdb4e0ead231dacc602
TEKSTI	1ab27b42a7b55da5dcdad41da59299ff2d131c1dacf2104a44e718dc8a1e4492
PAMJA	8dc1c64528467ce5cbaece2c3848b94297592cac6eb8f46bac656e9f4eab8d01

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6f73b6272d3257038dfc9c4affe18f25763e9de07d6d1a040bd441ad666252f4
E MËPARSHMJA	81d1d8770c27eed36ee18216e076ff720aa89b830ae7935ccba6555c4f19638b
RRËNJA MERKLE	89f030d876ccea6b0e23b6ac39c6b069c94f8f32995a6e60ca310d5733a1b6e5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6f73b6272d3257038dfc9c4affe18f25763e9de07d6d1a040bd441ad666252f4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Ballina](#)
- [Lajme](#)
- [Sport](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Auto](#)
- [Kuriozitete](#)
- [Indeks+](#)
- [Ekonomi](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Zgjedhjet](#)
- [Opinion](#)

Kërko...

 Kërko produktin...  

SHPËRNDAJE



15:26 / E Premte, 04 Shtator 2026 / Z S

Sketching Pristina: Artistë nga Kosova, Franca dhe Spanja vizatojnë qytetin me mbështetjen e BE-së



Një cep rruge, drita që bie mbi një ndërtesë, një monument apo një skenë e zakonshme në treg mund të bëhen momente që ia vlen të ndalesh e t'i vëzhgosh, aq më tepër kur qyteti shihet përmes një biloku të skicave. Përgjatë tri ditëve në fillim të shtatorit, me mbështetjen e BE-së në Kosovë dhe Komunës së Prishtinës, pesë artistë të ftuar nga GRAN Fest ecën rrugëve të Prishtinës në kërkim të këtyre momenteve.

Edicioni i parë i **Sketching Pristina**, projekt i GRAN Fest për shkëmbim kulturor dhe art urban, bëri bashkë Enrique Flores dhe Pedro Espinosa nga Spanja, Aurélie Calmet dhe Emmanuel Prost nga Franca, si dhe Liza Dervishaj nga Kosova.

Nisma u dha artistëve kohë për të eksploruar qytetin dhe për të dokumentuar nga këndvështrimet e tyre rrugët, lagjet, njerëzit dhe përditshmërinë e Prishtinës.

Përtej dokumentimit të qytetit, Sketching Pristina krijoi hapësirë për shkëmbim mes artistëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Për themeluesin dhe Drejtorin Artistik të GRAN Fest, Gani Jakupi, mbështetja e BE-së kontribuoi në një shkëmbim që është njëkohësisht edhe një formë e diplomacisë kulturore.

“Është një lloj diplomacie kulturore. Në njërën anë, artistët që vijnë këtu krijojnë një përshtypje shumë më të mirë sesa po të vinin vetëm për vizitë. Në anën tjetër, ata i marrin këto imazhe me vete. Ne do t'i ekspozojmë punimet këtu, por ata i marrin origjinalet edhe i ekspozojnë edhe në vende të tjera. Ka me qenë një mënyrë e shpërndarjes së imazhit të Kosovës, ideale.”

Angazhimi më i gjerë i BE-së në sektorin kulturor dhe kreativ të Kosovës mbështet mundësi që lidhin artistët në Kosovë me kolegët e tyre në vende të tjera të Evropës dhe ndihmojnë që skena kulturore e Kosovës të arrijë te një publik më i gjerë.

Ky shkëmbim mori formë në rrugët e Prishtinës. Gjatë tri ditëve, artistët lëvizën nëpër qytet, duke u ndalur sa herë që diçka ua tërhiqte vëmendjen. Disa prej pikave më të njohura të Prishtinës u hodhën në letër, përfshirë monumentin NEWBORN, Çarshinë e Vjetër, Sahat Kullën dhe Muzeun Etnologjik.

Për ilustratorin spanjoll Enrique Flores, i cili punon me *El País*, kjo ishte vizita e dytë në Kosovë, pasi vitin e kaluar kishte marrë pjesë në GRAN Fest.

“Kjo është hera ime e dytë në Prishtinë dhe Kosovë. Pata fatin të ftohëm në GRAN Fest vitin e kaluar, ndërsa këtë vit jam përsëri këtu për edicionin e parë të Sketching Pristina. Më pëlqen ta vizitoj Prishtinën sepse është një qytet shumë piktoresk, plot kontraste, peizazhe dhe njerëz shumë të mirë.”

Pas tri ditësh skicimi, aktiviteti përfundoi më **3 shtator me hapjen e një ekspozite në Europe House Pristina**, ku punimet e realizuara gjatë programit iu prezantuan publikut.

Mbështetja e BE-së për Sketching Pristina është pjesë e partneritetit të saj më të gjerë me Kosovën. Bashkimi Evropian është ofruesi më i madh i asistencës financiare për Kosovën dhe, që nga viti 1999, ka investuar mbi 3.7 miliardë euro në fusha që përfshijnë zhvillimin ekonomik, arsimin, kulturën, shoqërinë civile dhe fuqizimin e institucioneve.

Mos i humb

- [Një veturë e FSK-së përfshihet në një aksident trafiku në kryeqytet \(Foto\)](#)



- [“Ndryshoi jetën time”, ushtari i KFOR-it kujton momentin e hyrjes në Kosovë 25 vjet më parë](#)





-

- [Hajdari: Roli i Avokatit të Popullit të mos involvohet në procedura gjyqësore](#)



- [AKB: Rreth 40 për qind të bizneseve s'e përdorin arkën fiskale në mënyrën e duhur](#)



- [Aksidenti i rëndë në autostradën "Ibrahim Rugova", të lënduarve po iu ofrohet ndihma mjekësore](#)



[Facebook](#) [Follow](#) [Instagram](#)

Të fundit nga Showbiz

-  [23:30 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Motra e Laurent Krasniqit thyen heshtjen pas humbjes së rëndë](#)
-  [23:00 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Eva në deti, 'nxehet' interneti](#)



-  [22:30 / E Diele, 06 Shtator](#)

[Bad Bunny vazhdon të thyejë rekorde, 7 çmime Emmy për shfaqjen e Super Bowl](#)



- [22:00 / E Diele, 06 Shtator](#)

[Pamje ekskluzive, martohet vajza e Bedri Hamzës, kryetari i PDK-së vallëzon me çiftin](#)



- [21:30 / E Diele, 06 Shtator](#)

[Pse bën paraqitje publike nu*do? Bianca trazon rrjetin](#)



- [21:00 / E Diele, 06 Shtator](#)

[Doarsa, Hykmetja apo Jehona? Ja cila deputete e LDK-së ka më shumë ndjekës në Facebook](#)

TEL

Redaksia: +383 (0) 48 36 36 39 | Marketing: +383 (0) 49 686 666

EMAIL

info@indeksonline.net

marketing@indeksonline.net



[Indeksonline.net](https://indeksonline.net)



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.